

Projekti i OSBE-së, i KE-së dhe ambasadës holandeze për luftën antikorrupsion



Në kuadër të projektit për forcimin e shoqërisë civile në promovimin e parimeve të luftës kundër korrupsionit në strukturat e sistemit e qeverisjes lokale, Bashkia Kamëz u përzgjedh në zbatimin e projektit. Kjo përzgjedhje nuk erdhi rastësisht, por si rrjedhojë e bashkëpunimeve të suksesshme të mëparshme, veçanërisht për përgatitjen e dokumentit “Strategjia e zhvillimit të Kamzës (2008-2015)”, prezantimit nga bashkia “Praktika më e mirë qeverisëse One Stop Shop” një sërë aktiviteteve të suksesshme të programuara nga bashkia për Javën Evropiane të Demokracisë Lokale, si edhe bashkëpunimit të ngushtë të saj me shoqatat joqeveritare. Pas nënshkrimit të marrëveshjes në fund të vitit 2009 për projektin antikorrupsion nga Bashkia Kamëz dhe organizmat ndërkombëtarë mbështetës të projektit, OSBE



Komisioni Evropian dhe ambasada holandeze, filloi zbatimin e tij, nëpërmjet shoqatës joqeveritare “Instituti për Kërkime Urbane”. Kjo shoqatë, nëpërmjet bashkëpunimit me Bashkinë Kamëz, ndërtoi një plan operacional veprimi, në të cilin janë përfshirë aktivitete që evidentojnë dhe mbështesin nevojat ndërhyrëse e përmirësuese, që kjo bashki ka aktualisht dhe në të ardhmen, për të rritur efektivitetin dhe rezultatet e mëtejshme në këtë fushë. Projekti nëpërmjet vëzhgimit, monitorimit dhe informacionit të mbledhur, ka konkluduar se Bashkia Kamëz përbën një shembull, model, për qeverisjet e tjera vendore të Shqipërisë, për instrumentet e ngritura dhe metodat e hapura e të drejtpërdrejta të përdorura prej saj. Veçanërisht, këtu është evidentuar dhe vlerësuar shumë roli i qendrës së shërbimeve One Stop Shop, e cila jo vetëm ka rritur cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve e biznesit, por edhe ka siguruar kontakte direkte, informacion të plotë e transparent me publikun, çka ka rritur besueshmërinë dhe mbështetjen e publikut ndaj institucionit dhe punonjësve të tij. Si një nga komponentët e rëndësishëm të projektit, është roli dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në marrëdhëniet me pushtetin vendor dhe komunitetin. Edhe në këtë drejtim bashkia ka mbështetur projektin, duke ftuar shoqatat që veprojnë në territorin e saj, për të marrë pjesë aktive në projekt, në seancat e trajnimeve dhe aktiviteteve të parashikuara nga projekti, për të rritur rolin e tyre bashkëpunues dhe qeverisës në nivel vendor. Por, siç ka dalë edhe nga diskutimet në këto seanca, vetë shoqëria civile (e përfaqësuar sidomos nga OJF-të) ka nevojë të bëjë transparencë dhe të informojë për fondet dhe aktiviteteve që kryen për publikun e gjerë, por edhe instancat partnere në nivel vendor, ku kryhen këto aktivitete.